



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" DURRËS  
REKTORATI

Nr. 558 prot

Durrës, më 29.04.2021

**V E N D I M**

Nr. 7, datë 29.04.2021.

Në mbështetje të ligjit nr. 80/2015, "Për Arsimin e Lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 685 datë 25.08.2010 "Për riorganizimin e Universitetit "Aleksandër Moisiu", Durrës", të ligjit nr. 8480, datë 27.05.1999 "Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike", të Statutit të Universitetit, të Rregullores së Universitetit, Rektorati

**V E N D O S I:**

1. Ngarkimin e Dekanëve të Fakulteteve, Drejtorëve të drejtorive, koordinatorëve të fakulteteve, në marrjen e masave për vënien në dispozicion të dokumentacionit të kërkuar nga grupi i punës në kuadër të akreditimit institucional.
2. Ngarkimin e Dekanëve të Fakulteteve, Sekretarive mësimore, në marrjen e masave për plotësimin e regjistrave të gjeneraliteteve.
3. Ngarkimin e Dekanëve të Fakulteteve, për studentët ndër vite të cilët kanë probleme me numrat e matrikullimit për shkak të mungesës së dokumentacionit, të vënë në dijeni studentët përkatës me shkresë zyrtare.
4. Ngarkimin e Dekanëve të Fakulteteve, të vënë në dijeni stafin dhe studentët e ciklit të dytë Master i Shkencave për detyrimin e dorëzimit të provimit të gjuhës së huaj si kusht për të vazhduar me procedurën e mbrojtjes së temës së diplomës.
5. Ngarkimin e Dekanëve të Fakulteteve në marrjen e masave për vazhdimësinë e semestrit të dytë për vitin akademik 2020-2021.
6. Për semestrin e dytë të vitit akademik 2020-2021 nuk do të ketë provim të ndërmjetëm.
7. Ngarkimin e Dekanëve të Fakulteteve në marrjen e masave për realizimin e konferencave ndërkombëtare, konferenca studentore, aktivitete kërkimore shkencore.

8. Ngarkimin e Dekanëve të Fakulteteve, Zv.Dekanëve për Kerkimin Shkencor, Drejtorisë së Projekteve dhe Marrëdhënieve me Jashtë në informimin e studentëve për pjesëmarrje në mobilitete që ofron universiteti.
  9. Ngarkimin e Administratorit, në marrjen e masave urgjente për vënien në dispozicion të kartonave të diplomave sipas fakulteteve përkatëse.
  10. Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi
    - Zv.Rektorët
    - Administratori
    - Dekanët e Fakulteteve
    - Drejtoret e Drejtorive
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

R E K T O R

Prof.Dr. Kseanida SOTIROFSKI



The stamp is circular and contains the text: "REPUBLIKA SHQIPERISE" at the top, "DURRES" at the bottom, and "UNIVERSITETI PALEKSANDE" at the bottom. In the center, there is a coat of arms of Albania. The name "SOTIROFSKI" is written across the stamp, and there are several horizontal lines drawn over it, indicating a signature.